



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I QARKUT DIBER**

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Albania Tel. + 355.218.22170, Fax +355.218.22324; e-mail: [njesiatrajnuese@yahoo.com](mailto:njesiatrajnuese@yahoo.com)

**VENDIM**

**Nr. 21, datë 24.02.2016**

*"Për miratimin e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme"*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, shkronja "n"; si dhe VKM Nr. 608 date 05.09.2013, "***Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre***" pika 7, me kërkesë të Bashkisë Dibër sipas shkresës së saj me Nr. 718 protokolli datë 16.02.2016, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e tij të datës 24.02.2016 pasi mori në shqyrtim Vendimin Nr. 21, datë 22.02.2016, të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Dibër "***Për miratimin e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme***",

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e kalimit në pronësi të objekti dhe truallit në funksion të tij për **z. Gëzim Isuf Kallaverja** në përputhje me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Dibër.
- II. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Projekteve Rajonale dhe Urbanistikës në Këshillin e Qarkut Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

Hajri LAÇI